

Maj 2024 | Nr. 38

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE NË SHBA





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE NË SHBA

Uashington D.C., 8 Maj 2024

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani ka nisur një vizitë pune në SHBA, me takime me drejtues kyç në Departamentin e Drejtësisë së SHBA, të mundësuar nga Zyra për Zhvillimin, Ndhimën dhe Trajnimin e Prokurorisë Jashtë Vendit (OPDAT) në Ambasadën e SHBA në Tiranë.


Gjatë vizitës së tij në Uashington DC këtë javë, z. Metani u takua me Inspektorin e Përgjithshëm të Departamentit të Drejtësisë Michael Horowitz, Zëvendës Ndhmës Prokurorin e Përgjithshëm Bruce Swartz dhe Këshilltarin e Zyrës së Përgjegjësisë Profesionale Jeffrey Ragsdale.

Zyrtarët amerikanë riafirmuan mbështetjen

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani ka shprehur mirënjohjen për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të SHBA në forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në drejtim të efikasitetit dhe profesionalizimit të ekipit të Zyrës së ILD-së.



e Shteteve të Bashkuara për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në misionin e saj jetik në mbështetje të profesionalizimit, pavarësisë dhe integritetit mes gjyqtarëve dhe prokurorëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani ka shprehur mirënjohjen për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të SHBA në forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në drejtim të efencës e profesionalizimit të ekipit të Zyrës së ILD-së.





METANI: SISTEMI I DREJTËSISË KA NEVOJË PËR INKURAJIM E MBËSHTETJE

Nju Jork, 9 Maj 2024

Në vijim të vizitës së punës në SHBA, e në kuadër të Ditës kombëtare të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një bashkëbisedim me juristë dhe profesionistë shqiptarë në Nju Jork, një takim i organizuar nga “Rrjeti i Profesionistëve dhe Sipërmarrësve Shqiptarë” (The Albanian Professionals and Entrepreneurs Network- APEN).

Bashkëbisedimi u drejtua nga gjyqtarja e parë shqiptare e zgjedhur në Nju Jork, znj. Edit Shkreli e Gjykatës Civile të Bronksit, me të cilën z. Metani u ndal tek ndryshimet e realizuara në Shqipëri në kuadër të

reformës në drejtësi me institucione të reja, një prej të cilave është edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pas prezantimit të rolit dhe funksioneve të institucionit që drejton, z. Metani iu përgjigj interesimit mbi aspekte të ndryshme të shtetit të së drejtës dhe institucioneve në Shqipëri.

Duke folur për ndryshimet dhe pritshmëritë ndaj sistemit të drejtësisë, z. Metani solli në vëmendje rolin e institucioneve, por edhe të shoqërisë, në raport me drejtësinë e shtetit e së drejtës.

“Ne kemi nevojë për një shoqëri që zhvillohet dhe përparon bazuar në koncepte të demokracisë dhe të shtetit ligjor, sepse



drejtësia nuk mund të administrohet vetëm nga institucionet e saj, por edhe nga shoqëria, përmes informimit, sjelljes etike dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Drejtësia është një temë që ngjall interes publik. Sot duhet të shtojmë përpjekjet për ritjen e nivelit të kulturës juridike të shoqërisë sonë. Aksesi i shtetasve shqiptarë mbi njohuritë mbi ligjin është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë apo tjetër, nuk janë të lidhura vetëm me arsimi-





min juridik, por janë përbërësit e kulturës të drejtat dhe detyrimet e tyre. Të kuptojnë dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit rolin dhe funksionet e institucioneve dhe të së drejtës.

Në të njëjtën kohë, shtetasve shqiptarë u shtetin e së drejtës. Shtetasit shqiptarë duhet dhënë mundësia, që të orientohen mund të organizohen e bashkëveprojnë për brenda spektrit të gjerë ligjor, duke njohur të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve të



“Ne kemi nevojë për një shoqëri që zhvillohet dhe përparon bazuar në koncepte të demokracisë dhe të shtetit ligjor, sepse drejtësia nuk mund të administrohet vetëm nga institucionet e saj, por edhe nga gjithë shoqëria, përmes informimit, sjelljes etike dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Sot, sistemi i drejtësisë ka qenë dhe mbetet një nga temat më të nxehta të debatit publik në Shqipëri.– tha

sistemit të drejtësisë, si dhe të ushtrojnë sistem drejtësie i pavarur, me integritet, presion me mjete demokratike mbi këto organe, për të nxitur mbarëvajtjen e çështjeve me interes publik.

Ne duhet të punojmë për ndryshimin e mentalitetit të aktorëve të sistemit të drejtësisë, i cili duhet të bazohet në një kuptim të plotë të shtetit të së drejtës. Është e rëndësishme që shoqëria shqiptare të përqafojë frymën dhe rregullat e një kulture të përgjithshme të sundimit të ligjit. Pa një kulturë të thellë juridike, sistemi i drejtësisë kthehet në një sistem sipërfaqësor formal dhe pa vlera. Një

transparent dhe efikas do të garantohet vetëm nëse shteti i së drejtës përvetësohet nga të gjithë ne, nga magistratët, nga profesionistët e së drejtës, klasa politike, media, shoqëria civile, si dhe vetë shtetasit shqiptarë” tha mes të tjerash Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në takim përshëndeti edhe përfaqësuesja e përhershme e Shqipërisë në OKB, ambasadore Suela Janina, e cila vlerësoi rolin dhe punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistem dhe për forcimin e





Albanian Professionals and
Entrepreneurs Network (APEN)
proudly presents



JUDGE EDIT SHKRELI
New York City Civil
Court, Bronx County

in conversation with



MR. ARTUR METANI
High Inspector of
Justice, Albania

Thursday, May 9 | 6:30PM
Impact Hub NY
417 5th Ave, Suite 814
New York, NY 10016




shtetit të së drejtës. Gjatë bashkëbisedimit me profesionistë të së drejtës, z. Metani i ftoi të bashkëpunojnë ose punojnë me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Eventi është pjesë e konceptit të komunikimit publik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes organizimit të forumeve të hapura e takimeve me shtetas shqiptarë, të cilët përfaqësojnë një model të suksesshëm nga pikëpamja shoqërore dhe

profesionale në fushën e të drejtës, jo vetëm në Shqipëri po edhe jashtë saj.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve synohet kontributi i këtyre individëve, që nëpërmjet prezantimit të arritjeve të tyre personale, sfidave të hasura si dhe sukseseve të arritura, të jepen modele të mira për t'u ndjekur, pse jo të kontribuojnë personalisht në ecurinë e zbatimit të Reformës në Drejtësi në Shqipëri.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PARAQET VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani ka informuar Komisionin parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023.

Z. Metani tha se “2023-shi ka qenë intensiv për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sa i takon funksionit kryesor, me rezultate të dukshme, duke u bazuar në trajtimin të ankesave ndaj magjistratëve dhe inspektimeve tematike, e paralelisht,

finalizimit të stokut të ankesave e praktikave të mbartura nga institucione të mëparshme të procedimit disiplinor”.

Trajtimi i ankesave të trashëguara, ka qenë një proces që e ka tejkaluar ngarkesën normale të punës për burimet njerëzore në dispozicion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një sfidë që e kemi kapërcyer masat rregullatore, administrative dhe strukturore të ndërmarra. Evadimi i stokut

Z. Metani tha se :“2023-shi ka qenë intensiv për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sa i takon funksionit kryesor, trajtimin të ankesave ndaj magjistratëve dhe inspektimeve tematike, e paralelisht, finalizimit të stokut të ankesave e praktikave të mbartura nga institucione të mëparshme të procedimit disiplinor”.



të ankesave përbushi synimin tonë të përsëritur publikisht, se asgjë nuk harrohet dhe se shmangia e kulturës së pandëshkueshmërisë është një sinjal i qartë për të rritur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.”

Më pas Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ndal në nivelin e zbatimit të rekomandimeve të

Rezolutës së Kuvendit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022, prioritetet e vëna për vitin pasues, të identifikuara nga puna e përditshme e të gjitha njësive dhe drejtorive të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si nga komunikimet me qytetarët ankuar, institucionet apo proceset e punës së përditshme.





DISKUTOHET RREGULLORJA PËR BASHKIMIN E PROCEDIMEVE DISIPLINORE PËR MAGJISTRATËT NË KLGJ E KLP

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në mbledhjen e përbashkët plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në ditën e Drejtësisë, ku u paraqit dhe u diskutua draft-rregullorja “Për bashkimin e procedimeve disiplinore për rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkelje”

Inspektorja magjistrate znj. Elena Pelushi u shpreh në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, se me këtë akt vendosen standarde të njëjta dhe të qëndrueshme gjatë procedimit disiplinor të magjistratit, duke garantuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor të parashikuara nga kuadri ligjor dhe vendosura tashmë në praktikat e

punës të ndjekura nga ILD dhe nga të dy Këshillat.

“Sistemi llogaridhënës duhet të udhëhiqet pikësepari nga nocioni i përgjegjshmërisë së magjistratëve, si një mekanizëm parandalues dhe që siguron ndërtimin e një sistemi të pavarur drejtësie. Zbatimi uniform i parashikimeve ligjore si dhe konsolidimi i standardeve që garantojnë një proces disiplinor të drejtë, të paanshëm, transparent, të pavarur dhe që përshkohet në të gjitha hallkat e tij nga parimi i procesit të rregullt ligjor, përbëjnë themelet për ngritjen e një sistemi eficient të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së magjistratëve, i cili është dhe mbetet qëllim i përbashkët i institucioneve tona dhe i



reformës në tërësi.“ tha znj. Pelushi.

Procesi i draftimit të kësaj rregulloreje ka kaluar në faza të gjata konsultimesh dhe diskutimesh ndërmjet anëtareve të grupit

të punës, në të cilin ishin përfshirë Komisionet Disiplinore të secilit prej Këshillave dhe përfaqësues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nën asistencën e ekspertëve të misionit EU4JUSTICE.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës kanë zyrtarizuar bashkëpunimin, përmes një marrëveshje, që u nënshkrua nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës z. Arben Rakipi.

Memorandumi parashikon bashkëpunimin e ngushtë për çështje me interes të përbashkët, në drejtim të forcimit të bashkëpunimit për përfshirjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të moduleve dhe temave të trajnimit, të përshtatshme në interes të inspektorëve dhe ndihmësinpektorëve pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit çdo vit.

Ky bashkëpunim në nivel akademik do shoqërohet me organizimin e konferencave

të përbashkëta, leksioneve të hapura apo aktiviteteve të tjera në funksion të rritjes së efikasitetit të veprimtarisë dhe zhvillimit profesional të inspektorëve dhe ndihmësinpektorëve, e më tej edhe në shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit në lidhje me analiza apo të dhëna, që i shërbejnë aktiviteteve të përbashkëta.

Fuqizimi i kapaciteteve të ekipit të inspektimit mbetet prioritet i qëndrueshëm i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një proces pune që parashikon trajnime periodike me institucione homologe të vendeve të Bashkimit Evropian, e nga institucione ndërkombëtare, partnerë të ILDS-së, që tashmë do plotësohet si praktikë e qëndrueshme, me zyrtarizimin e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës.



KLJGJ PRANON KËRKESËN E ILD PËR SHKARKIMIN E MAGJISTRATES Z.V.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar në seancën e sotme dëgjimore, kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën ‘Shkarkim nga detyra’ për magistraten Z.V., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

ILD ka nisur hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magistrates Z.V., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të dënimit për kryerjen e veprës penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç Kodit Penal. Hetimi disiplinor i kryer

nga inspektorët e ILD-së konkludoi se gjyqtarja është gjetur fajtores dhe është dënuar nga Gjykata e Posaçme Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç të Kodit Penal.

Ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magistrates, edhe për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore, e që ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magistrati dhe tek organet e drejtësisë. Inspektorët e ILD kërkuan caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, kërkesë që u pranua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

MAJI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Maj** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **107 ankesa**, nga të cilat 105 janë paraqitur nga qytetarë dhe **2 ankesa** nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Maj 2024**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p>45 vendime nga 129 praktika të shqyrtuara (84 ankesa të bashkuara) konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none">♦ - 31 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar♦ - 14 vendime arkivimi pas verifikimit	<p>9 vendime verifikimi</p>	<p>1 vendim fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat</p>

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Maj 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **6 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.






Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Maj 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 28 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 19 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve,

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Maj 2024**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **15 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani reposted
USEmbassyTirana @USE... · 8.5.24
 The Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance, and Training (#OPDAT) at the U.S. Embassy in Tirana was proud to facilitate a meeting between High Inspector of Justice Artur Metani and key leaders at the U.S. Department of Justice. During his visit to Washington DC... Show more



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Mirënjohje për inkurajimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të SHBA në forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në drejtim të efencës e profesionalizmit të ekipit të Zyrës së ILD

Translate post



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Kënaqësi komunikimi me profesionistë në NY. Krenari për **Edit Shkreli** gjyqtarja e parë shqiptare e zgjedhur në Nju Jork. Uroj të hapë rrugën edhe për të tjerë profesionistë të talentuar. @APEN_USA për organizimin Ambasadore @suelajanina ild.al/sq/2024/05/10/...

Translate post



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Fuqizimi i kapaciteteve të inspektimit mbetet prioritet i qëndrueshëm i #ILD, me trajnime periodike me institucione homologe të vendeve të BE, nga institucione ndërkombëtare e tashmë si praktikë e qëndrueshme me memorandumun me Shkollën e Magjistraturës ild.al/sq/2024/05/16/...



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në konferencën përmbylëse të projektit COPEJ " Bashkëpunimi në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë". #ILD #RESJ #Copej

Translate post



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë... · 23.5.24

Inspektori i Lartë i Drejtësisë performon me standarde, standarde të konfirmuara nga këshillat dhe nga KPA. Dhe kjo është themelore për t'u trajtuar si standard pune i kontrollit të jashtëm që bën Inspektori i Lartë i Drejtësisë. #ILD #Informiparlamentar

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

"Unë nuk jam SPAK-u dhe nuk do bëhem asnjëherë SPAK-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kjo është themelore sa i përket institucionit të kontrollit të jashtëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve siç është #ILD..."

Translate post



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

Po ndodh: Njësitë e inspektimit të #ILD-së: Përgatitja, kryerja dhe analizimi i inspektimeve klasike tematike, me fokus shërbimet e prokurorisë. Një angazhim i përbashkët i #CEPEJ #SEJIV & #EU4Justice #ILD

Translate post



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur M... @ILD_Albania

A keni dëshirë të kontribuoni në përmirësimin e sistemit të drejtësisë? #ILD ka shpallur 4 vende për Inspektorë jomagjistratë. Shikoni kushtet e kriteret dhe aplikoni! Afati për dorëzimin e dokumentacionit është data 26.06.2024

Translate post




From ild.al



PRAKTIKA TË KLGJ-SË SPANJOLLE PËR TRANSPARENCËN E ILD-SË

Një mision afatshkurtër ekspertësh nga përmirësuar efikasitetin dhe transparencën Këshilli i Lartë Gjyqësor i Spanjës zhvilluan e ILD-së, duke konsideruar dosesione pune me punonjës të Zyrës së ILD-së, me synim kryerjen e një analize një sistemi plotësisht elektronik të gjithëpërfshirëse të situatës aktuale përpunimit të ankesave teknologjike të institucionit.

Aktiviteti synonte vlerësimin e situatës aktuale dhe sugjerimin e masave për të Anëtarë të kabinetit, punonjës të njësisë së ndihmës inspektorëve, drejtorisë së hartimit të akteve dhe shërbimeve juridike, të






sektorit të metodikës e standardeve, sektorit të teknologjisë së informacionit dhe sektorit të arkiv-protokollit, u njohën nga ekspertët spanjollë të teknologjisë së informacionit e dokumentacionit me kontekstin e gjyqësorit spanjoll, praktikat më të mira, instrumente dhe modelin e motorit të kërkimit të vendimeve në praktikat

gjyqësore. Ekspertët e KLGJ-së spanjolle paraqitën praktikën e gjyqësorit në sistemin me një ndalesë, për akses në të dhëna, informacion e ndërveprim.

Aktiviteti është pjesë e mbështetjes së projektit EU4Justice për forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.





DREJTËSIA NË MBROJTJE TË MJEDISIT, SI PRIORITET EUROPIAN


Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit COPEIJ “ Bashkëpunimi në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë”, që ka bërë bashkë përfaqësues të Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë, Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë të Italisë, Këshillit të Lartë të Gjyqësorit të Portugalisë, Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, anëtarë të Rrjetit Europian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ).





I nisur dy vite më parë, me financim të Komisionit European, projekti COPEIJ synon të mbështesë dhe promovojë efektivitetin e mbrojtjes së mjedisit nga drejtësia penale në BE, duke përfshirë shërbimet kombëtare të inspektimit, në kuadër të direktivës së re të Bashkimit European të 11 prillit 2024 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal,

e që i detyron vendet anëtare të adoptojnë brenda dy viteve, rregulla kombëtare në përputhje me parashikimet e kësaj direktive. Gjatë eventit përmbyllës, që u mbajt në mjediset e Eurojust në Hagë, u paraqitën dhe diskutuan sfidat e luftës kundër krimit mjedisor në Europë, veçanërisht në fushën e





luftës kundër krimit të organizuar, zhvillimet e fundit në këtë fushë, dhe u vlerësuan praktikat dhe risitë e mira të identifikuar nga ekipi COPEIJ për të përmirësuar efektivitetin e tij.

Funksionarë dhe ekspertë nga Komisioni European, Eurojust, Europol, magistratë, drejtues të organeve ligjzbatuese që merren me krimin mjedisor, avokatë dhe pedagogë nga vende të BE diskutuan për dy ditë mbi luftën ndaj krimit mjedisor në Evropë, fenomenet dhe prioritetet kombëtare, sfida të luftës kundër krimit mjedisor: organizimi gjyqësor për një drejtësi efikase. Harmonizimi i standardeve dhe praktikave gjyqësore, mekanizmat për të përmirësuar luftën kundër krimit mjedisor.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u përfaqësua nga këshilltaret znj. Isida Koka dhe znj. Mimoza Koçiu.

Znj. Koçiu moderoi tryezën e tretë rumbullake me temë “Lufta kundër krimit të organizuar ndërkufitar”. Bazuar në një metodologji të përbashkët, përfaqësuesit e shërbimeve të inspektimit të drejtësisë, pjesë e projektit COPEIJ kanë përgatitur raporte kombëtare dhe më pas një raport të përbashkët, duke identifikuar vështirësitë kryesore dhe duke paraqitur praktikat e mira në lidhje me krimin mjedisor dhe rekomandimet e përbashkëta, një dokument që do i dorëzohet Komisionit European.

Funksionarë dhe ekspertë nga Komisioni European, Eurojust, Europol, magistratë, drejtues të organeve ligjzbatuese që merren me krimin mjedisor, avokatë dhe pedagogë nga vende të BE diskutuan për dy ditë mbi luftën ndaj krimit mjedisor në Evropë.



ILD KËRKON TË REKRUTOJË INSPEKTORË JOMAGJISTRATË

Në përmbushje të misionit të veprimitarisë hetimore, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë fton të gjithë personat e interesuar, të aplikojnë për 4 (katër) vende vakante për pozicionin “**Inspektor jomagjistrat**” në Njësinë e Inspektorëve pranë ILD-së.

Inspektori kryen verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Në ushtrimin e detyrës së tij, inspektori mbledh të dhëna dhe vlerëson çdo informacion, ose akt që çmon se është, ose mund

të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për kandidatët e interesuar, kushtet, kriteret, dokumentacioni paraprak dhe mënyra e dorëzimit, gjenden në linkun: <https://ild.al/wp-content/uploads/2024/05/Shpallje-Inspektore-Jomagjistrate-27.05.2024.pdf>

Më shumë informacion lidhur me shpalljen dhe kriteret e kualifikimit, gjeni në linkun: <https://ild.al/sq/rekrutim-inspektore-jo-magjistrate/>

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është data 26.06.2024.

MAJ 2024


Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)

